

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me sekretaren juridike Azize Rama, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit N.K.i nga Vitia Rr”NN.” pa nr, kundër të paditurve V. S.(T.) nga Vitia tani me adresë të panjohur , të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. L. E. nga Vitia, dhe Xh. M. nga fshati Gj. K.Vitisë, baza e kontestit vërtetimi i të drejtës së pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 07.12.2016, shpallë këtë;

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit N. K. nga Vitia dhe **i njihet** e drejta e pronësisë në ngastren kadastrale nr.XXX , ne vendin e qujtur “J.R.” ne sipërfaqe prej xxxx m2. ZK Viti, e regjistruar në emër të pronarit V. S. (T), **në bazë të shitëblerjes.**

DETYROHEN të paditurit V. S. nga Vitia tani me adresë të panjohur dhe Xh. M. nga fshati Gj. K.Vitisë t’ia njohin të drejtën e pronësisë paditësit N.K. nga Vitia dhe të durojë që ngastra e lartpërmendur t’i regjistrohet në emrin e paditësit.

Ky aktgjykim për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Viti, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

II.Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

A r s y e t i m

Gjykata të paditurit V. S. (T) nga Vitia, i kishte dërguar përgjigje në padi, por përgjigjësja nuk ishte kthyer, sepse të paditurin ishte e pamundur t’i gjindet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, ne fletëkethese thuhej se i padituri ishte i panjohur.

Në seancën përgatitore më datë xxxx, paditësi N.K. nga Vitia Rr”T..”, ka mbetur në tërsi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykates qe te paditurit V. S. (T) nga Vitia t’i caktohet një përfaqësues i përkohshëm, ku gjykata kishte vendosur duke caktuar përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurin av. L. E. nga Vitia.

Paditësi ka mbetur ne teresi prane padise dhe kerkese padise dhe kerkoj nga Gjykata qe ti njihet e drejta e pronësisë ne ngastrën nr.xxxx ne vendin e qujtur “J. R.” në sipërfaqe prej xxx m2 ZK.Viti, ngase këtë ngastër e ka blere nga i padituri i dytë Xh. M. nga fsh. Gj.në vitin xxx kan përpiluar një kontratë private me daten xxxx ne mes paditësit dhe të paditurit të dytë Xh. M. nga fsh.Gj., të hollat ia ka dhënë të gjitha sipas kontrate, dhe ka hyrë në shfrytëzim dhe posedim pa u penguar nga askush.

I paduturi Xh. M.ka njoftuar gjykatën se këtë ngastër e kishte blerë nga një qytetar i nacionalitetit Serb, i cili për momentin nuk jetonë më në Viti, dhe nuk e kishte bërë bartjen, nga serbi ngastren e kishte blerë diku në vitin xxxx.

I padituri i dytë NN ka deklaruar: nuk e kundërshton padinë e as kërkesë padinë nga se është e vërtetë se këtë ngastër ja ka shitur N. K.t, ku dhe ka përpiluar një kontratë private me N. K.. Këtë ngastër e ka blerë nga një qytetarë i nacionalitetit serb që nga viti xxxx, i quajtur V. S.T, ku ja ka paguar ngastren në tërësi dhe që nga ajo kohë e ka punuar pa u penguar nga askush.

Në seancën e datës xxx, paditësi ka mbetur pranë padisë dhe kërkesë padisë dhe kerkoi nga Gjykata që t'i njihet e drejta e pronësisë në ngastren kadastrale nr.xxxx në vendin e quajtur "J. R.", në sipërfaqe prej xxxx m², ZK-Viti, këtë ngastër e ka blerë nga i padituri i dytë Xh. M. në vitin xxxx, ku e ka përpiluar kontratën private me datën xxxx me të paditurin e dytë Xh.t M., edhe të hollat ja ka dhënë të gjitha sipas kontratës, ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush i ka propozuar gjykatës që të caktoj një ekspert të gjeodezisë, me qëllim që të bëhet identifikimi i ngastres.

Përfaqësuesi i përkohëshëm i të paditurit V.S.n (T), av.L. E. ka deklaruar se e kundërshton padinë dhe kërkesë padinë , ndërsa nuk e kundërshtoi propozimin e paditësit N. K.që të caktohet një ekspert i gjeodezisë me qëllim të identifikimit të ngastres kadastrale.

I padituri i dytë Xh. M. ka deklaruar: nuk e kundërshtoi padinë e as kërkesë padinë ngase ishte e vërtetë se këtë ngastër ja ka shitur N. K. ku edhe e ka përpiluar një kontratë private në mes tyre, këtë ngastër e ka blerë nga V. S., në vitin xxxx, dhe ja ka dhënë të gjitha të hollat dhe ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim, deri sa ja ka shitur ngastren N.K.Nuk e kundërshtoi propozimin që gjykata të delë në vendin e ngjarjes së bashku me ekspert të gjeodezisë, me qëllim të identifikimit të ngastres se permendur. Kërkoi nga Gjykata, që për seancat e radhës t'i zhvilloj në mungesë së tij, ngase nuk kishte tjetër qka të deklaron.

Me datën xxx, Gjykata së bashku me ekspert të gjeodezisë, ka dalur në vendin e ngjarjes të quajtur "J. R.", në Viti me qëllim të identifikimit të ngastres xxxxx e cila ngastër për nga gjatësia shtrihej në Veri-Jug, nërsa për nga gjerësia në Lindje-Perendi, e cila me kultur kishte qenë e mbjellur me grur, kurse tash është sarrishtë.

Paditësi N. K. propozoi që për seancën e radhës të ndëgjohen dy dëshmitar që kan njohuri lidhur me shitblerjen e kësaj ngastre.

Në seancën kryesore të datës xxxx, paditësi kishte mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se ngastren kontestuese paditësi e ka blerë dhe e shfrytëzon pa u penguar nga askushë dhe e kishte paguar çmimin e kontraktuar dhe kishte hyrë në posedim të pa penguar nga askush. Po ashtu, paditësi N. K. kishte propozuar të dëgjohen dëshmitarët B. M. nga Viti Rr"Hi K." pa nr. dhe V. R. nga Kabashi Rr"D. e K." .

Përfaqësuesi i përkohëshëm i të paditurit av.L. E.i , nuk e kishte kundërshtuar propozimin e paditësit për ndëgjimin e dëshmitarve.

Paditësi N. K. deklaron pasi që kemi pranuar nga ana e Gjykatës, ekspertizen e ekspertit gjeodet nuk kemi vrejtje në ekspertizen e ekspertit.

Përfaqesuesi i perkoshem i të paditurit V. S.n T., av.L. E.i ka deklaruar:se e ka pranuar ekspertizën nga eksperti gjeodet, dhe nuk kishte vërejtje në ekspertizë.

Dëshmitari B. M. nga Vitia ka deklaruar : N. K. këtë ngastër e ka blerë nga i padituri i dytë Xh. M. në vitin xxxx dhe kishte qenë prezent kur është bërë pazar mes N. K. dhe Xh.t M., këtë ngastër janë marrur vesh për shumën e të hollave xxxx Euro, N. K. menjëher ja ka dhënë të hollat dhe ka hyr në posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush. Këtë ngastër i padituri i dytë e ka blerë prej një qytetati të nacionalitetit serb para xx viteve, dhe ka pas hyr në shfrytëzim dhe posedim në atë ngastër, pa u penguar nga askush, dhe qmimin kontraktuar në tërësi ja ka pagur serbit dhe serbi asnjëher nuk ishte ankur për këtë ngastër që mos t'i jetë paguat qmimi i kontraktuar.

Ne pyetjet e përfaqesuesi të perkoshem av.L. E. deshmitari përgjigjet: Serbi asnjeher nuk është ankuiar per mos marrje të qmimit të komtraktuar të hollave nga i padituri i dytë Xh. M.

Dëshmitari V.R. nga fsh.K.K.Vitisë ka deklaruar: E din se këtë ngastër N.e ka blerë prej një personi me emrin Xh., por mbiemri nuk iu kujtua, të hollat në tërësi ja ka pagur dhe se këtë ngastër e ka blerë para xxx viteve. Ishte prezent kur është bërë blerja e kësaj ngastre prej personit të quajtur Xh , dhe se ky person atë ngastër e kishte pas blerë prej një personi të nacionaliteti serb.

Gjykata kishte lexuar dhe shtjelluar këto prova: Qerfitikatën e pronës së ngastrës kadastrale P-xxxxx, të dates xxxx në emer të Vx Sx (T), dëftesen e dates xxxxx kontraten mbi shitblerjen e palujtshmërisë e dates xxxx në mes Xh. M. si shitës dhe N.K. si blerës, përgjegjëja e AKP me nr.xxxxxx VD e dates xxxxx, përgjegjëja e policies e dates xxxx dhe ekspertiza e dates xxxxx e përpiluar nga eksperti i gjeodezisë.

Në fjalën përfundimtare paditësi N. K. ka deklaruar: mbetet në tërësi si në padi dhe kërkesë padi dhe kërkoi nga gjykata që t'i njihet e drejta e pronësis në ngastrën kadastrale nr.xxxx në vendin e quajtur " Jxxx", në sipërfaqe prej xxxxm2,që kjo gjendje u vërtetua me ndëgjimin e dëshmitarëve B. M. dhe V. R. , daljes së gjykatës në vendin e ngjarjes, si edhe deklarata e të paditurit të dytë Xh. M. i cili nuk e kundërshtoi padinë dhe as kërkesëpadinë dhe deklaroi se këtë ngastër e ka blerë diku para xxx viteve nga serbi dhe se në vitin xxxx I njeti ja kishte shitur ketij- paditësit N. K.. Kërkoi nga Gjykata që t'i njihet e drejta e pronësisë sepse në bazë të provave dhe fakteve ka ekzistuar një raport juridiko civil i pa shkruar në mes paditësit dhe të paditurit të dytë Xh. M., kërkoi nga gjykata ta aprovoj padinë në bazë të provave të shtjelluara.

Në fjalën përfundimtare përfaqesuesi i perkohëshëm i të paditurit V.S. (T), av.L. E. ka deklaruar: në bazë të deklaratës së të paditurit të dytë të dhënë në gjykatë me datën xxxx, shihej se e ka blerë ngastrën në fjalë nga i padituri i pare V. S. dhe për këtë ka bërë një marrëveshje me shkrim dhe ja ka dhënë mjetet të hollat. Në bazë të deklaratave të dëshmitarëve që ndëgjuam vërtetojnë se paditësi N. K. , ia ka dhënë mjetet për ngastrën në fjalë të paditurit të dytë Xh.M.Kërkoi nga gjykata që në bazë të provave të prezantuara të vendos në pajtim me ligjin dhe provat e administrara.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 8, të LPK-së, vlerësoi provat veç e veç dhe si tërësi..

- Me leximin e çertifikatës së pronës, e dates dt.xxxx me ngastren kontestuese nr.xxxxx në emër të pronarit V. S. T., gjykata vërteton se padia përputhet plotësisht në subjektet si palë kontestuese.

-Eksperiza e ekspertit të gjeodezisë T. N.tregon përputhshmërinë e kërkesëpadisë në aspektin formal me gjendjen faktike në teren, si dhe gjendjen aktuale mbi shfrytëzimin e kësaj ngastre kadastrale.

-Deklaratat e dëshmitarve B. M. dhe V. R. të dhëna në seancën e fundit të shqyrtimit gjyqësor, e forcojnë kërkesën e paditësit në njëërën anë dhe besimin e gjykatës për ekzistimin e punës juridike.

Gjykata ka vërtetuar se në mes të paditurit të pare V. S.T. dhe Xh. M.kishte egzistuar raporti juridik, i cili edhe pse jo i lidhur në formën e shkruar, ai ka prodhuar efekt juridik, me faktin se paditësi ka hy në posedim në të njejtën palujtshmëri, të cilen edhe e mbanë më tej pa u penguar nga askush. Gjykata po ashtu ka vërtetuar se paditësi N. K.ka blerë ngastrën kadastrale nga i padituri i dytë Xh. M.

Gjykata për tërë këtë raport juridik mes palëve ndërgjyqëse u shërbye me të drejtën materiale e cila ishte në fuqi gjatë krijimit të këtyre raportëve, siç është neni 28, i LMD-së, sepse vullneti i palëve ka fuqi detyrimi dhe është mbi ligjin.

Andaj, gjykata duke u bazuar në gjitha këto prova dhe fakte të pakontestueshme, duke qenë e pavarur në vendosje miratoi kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës do t'i bartë paditësi N.K., neni 453, i LPK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI
C.nr.132/2014
Më. 07.12.2016

Sek. Juridike
Azize Rama

Gj y q t a r i,
Nexhat Aliu

UDHËZIMI PËR MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.